

Nëse pi një cigare marijuanë, a më çon kjo drejt përdorimit të drogave të tjera?

Të pish një cigare marijuanë nuk do të thotë që patjetër kjo do të çojë drejt përdorimit të substancave të tjera siç dëgjojmë zakonisht. Është e vërtetë që përdoruesit e substancave të tjera kanë përdorur si fillim kanabisin, por jo të gjithë përdoruesit e kanabisit bëhen patjetër konsumatorë të drogave të tjera të paligjshme.

A ndikon hashashi në ecurinë tuaj në shkollë dhe ne jetën e përditshme?

Po. Hashashi dëmton kujtesën, gjykimin dhe perceptimin.

Hashashi mund të dëmtojë ecurinë tuaj në shkollë, aktivitete të ndryshme sportive apo me shoqërinë tuaj.

Kultivimi i bimëve narkotike

Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Për më shumë informacione për drogat, mund t'i referoheni Aksion Plus në rrjete tona sociale ose në adresën www.ishp.gov.al ose mund të na kontaktoni në e-mail:



Adresa: **Aksion Plus;**
Rr. Nasi Pavillo; Nd 25. Prapa
ambasades amerikane. Tirane
cel. 0696178959
e-mail: gencaxionp@gmail.com
website www.aksionplus.net



dhe



FLISNI HAPUR ME TË RINJTË PËR DROGËN DHE NDIHMOJINI ATA TË RRITEN TË SHËNDETSHËM DHE TË SIGURT

26 Qershor 2023 - Dita Ndërkombëtare e
Luftës Kundër Trafikimit dhe Abuzimit të
Drogave.

Mbështetur nga:



Aktivitete të ndryshme në shkollat e mesme dhe media për parandalimin e drogës janë kryer dhe në kuadër të fushatës “Mbështet, mos dëno”.

Tiranë 2023

Me termin droga nënkuptojmë të gjitha ato substanca psikoaktive, të cilat kur merren ndikojnë në sistemin neurobiologjik të organizmit.

Substancat joligjore më të përdorura janë hashashi, heroina, kokaina, morfina, LSD-të, amfetaminat (ekstazi) dhe kërpudhat magjike.

Përdorimi i vazhdueshëm dhe abuziv i këtyre substancave dëmton rëndë shëndetin, edhe për një kohë të gjatë pas ndërprerjes së tyre. Studimet në fushën e varësisë dhe neurologjisë tregojnë se drogat ndryshojnë trurin tonë në mënyrë të papërcaktuar, në disa raste për një periudhë afatgjatë ose të përhershme.

Efektet që krijojnë drogat kur abuzojmë me to
Ndryshimi i vetëdijes, euforia, ngadalësimi i reagimeve psikomotore, ulja e rrahjeve të zemrës, frenimi i sistemit nervor përgjegjës për frymëmarrjen (ngadalësimi i frymëmarrjes), ankthi, perceptimi i deformuar, paranoja, sjelljet impulsive të pakontrolluara, anhedoni, pagjumësia, halucinacionet, kujtesa e dëmtuar, rreziku i infektimit nga HIV dhe sëmundjet e tjera seksualisht të transmetueshme, varësia, dëmtimet kardiovaskulare, kanceri në mushkëri, dëmtimi i sistemit endokrin dhe tretjes, çrregullimet mendore, dëmtimi i fetusit për gratë shtatzëna që abuzojnë.

Grupet më të riskuara për t'u ekspozuar ndaj abuzimit me drogat

Fëmijët dhe adoleshentët, të rinjtë, gratë, fëmijët që braktisin shkollën, personat me probleme psikologjike, personat e institucionalizuar, të burgosurit, si dhe personat që abuzojnë me substanca të ligjëruara si alkooli, anksiolitikët dhe antidepressivët.

Faktorët që ndikojnë në përdorimin e drogave
Kureshtja, harresa, problemet fizike dhe psikologjike, presioni social, kërkimi i kënaqësisë, si dhe një formë vetëtrajtimi i çrregullimeve mendore.

Faktorët që ndikojnë në abuzimin me drogat
Lloji i drogës, aksesibiliteti i tyre, problemet në marrëdhënie me familjen dhe moshatarët, përdorimi i alkoolit dhe nikotinës, sjelljet kriminale dhe shmangëse, arrijtjet mjaft të ulëta shkollore dhe akademike, problemet psikologjike.

Këshilla për një jetë pa drogë

1. Flisni me një person të cilit i besoni, prindit apo psikologut të shkollës nëse nuk dini si të reagoni ndaj një situatë të dhënë, sidomos kur hasni ndonjë nga moshatarët tuaj që përdor drogë.
2. Informohuni për drogat përpara se të vendosni nëse dëshironi të eksperimentoni me to. Flisni paraprakisht me psikologun e shkollës ose me mësuesit.
3. Këshilloni miqtë që të kërkojnë ndihmë nëse kanë probleme me drogën.
4. Zgjidhni mënyra të shëndetshme, si aktivitete sportive, kinema, grupe të leximit etj, për të kaluar kohën dhe për t'u ndjerë mirë në shoqërinë e njeri tjetrit.

A është e vërtetë që kanabisi shkakton varësi?
Kanabisi nuk shkakton varësi fizike. Kjo do të thotë se trupi nuk jep ndonjë shenjë në rastin kur ne ndalojmë përdorimin e tij. Por, ai mund të shkaktojë varësi psikologjike tek përdoruesit e rregullt. Ata nuk arrijnë të ndalin marrjen e substancës dhe mendojnë se nuk mund të jetojnë dot pa të. Varësia psikologjike sjell humbje të kontrollit të përdorimit, humbja e interesit.